



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.147

6 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr.64, datë 14.10.2010	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 7881
Vendim i Kuvendit nr.65, datë 21.10.2010	Për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të konstatuar papajtueshmërinë me mandatin të deputetit Ilir Beqja..... 7881
Vendim i Kuvendit nr.66, datë 21.10.2010	Për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar..... 7881
Dekret nr.6733 datë 20.10.2010	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 7882
Vendim i KM nr.563, datë 14.7.2010	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të Shërbimit Përmbarimor me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për Shërbimin e Përmbarimit..... 7883
Udhëzim i MPÇSSHB nr.1945, datë 4.10.2010	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore”..... 7884
Udhëzim i MPPT dhe i MF nr.36, datë 7.10.2010	Për një ndryshim në udhëzimin nr.40, datë 24.12.2008 “Për caktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë”..... 7906

Vendim i GJK nr.35, datë 27.10.2010	Me objekt: 1. Konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.917, datë 20.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. 2. Detyrimi e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar të ekzekutojë këtë vendim, të dëmshpërblejë dëmin financiar për vonesën e pagesës dhe dëmin jofinanciar në shumën 3 000 euro, si dhe të paguajë kostot dhe shpenzimet në shumën 3 000 euro.....	7906
Vendim i ERE nr.69, datë 30.9.2010	Për miratimin e rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike.....	7910
Vendim i ERE nr.70, datë 6.10.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.45, datë 30.7.2007 “Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Entit Rregullator të Tregut të Energjisë Elektrike të Turqisë.....	7911
Vendim i ERE nr.71, datë 11.10.2010	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të KESH sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.....	7911
Vendim i ERE nr.72, datë 11.10.2010	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të OST sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.....	7912
Vendim i ERE nr.73 datë 11.10.2010	Për licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k.....	7912
Vendim i ERE nr.74, datë 11.10.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7913
Vendim i ERE nr.75, datë 11.10.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7914
Vendim i ERE nr.76, datë 11.10.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k.	7914
Kërkesë e MPPT nr.4140/2, datë 14.10.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash-Morinë”	7915
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Lefter Luman Beqari.....	7917

VENDIM
Nr.64, datë 14.10.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.3, DATË 16.9.2009 “PËR
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe të neneve 55 pika 1 dhe 21, pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, pas marrëveshjes së Kryetares së Kuvendit me Kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, në pikën 1, bëhen këto ndryshime:

- I. Deputetët Ndue Paluca dhe Ilir Bano caktohen anëtarë në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.
- II. Deputetja Mesila Doda caktohet sekretare në Komisionin për Integrimin Europian.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.65, datë 21.10.2010

**PËR DËRGIMIN E ÇËSHTJES NË GJYKATËN KUSHTETUESE PËR TË KONSTATUAR
PAPAJTUESHMËRINË ME MANDATIN TË DEPUTETIT ILIR BEQJA**

Në mbështetje të nenit 78 pika 1, nenit 70 pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, si dhe të nenit 55 pika 1 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese për të konstatuar papajtueshmërinë me mandatin të deputetit Ilir Beqja, sipas nenit 70 pika 4 të Kushtetutës.
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.66, datë 21.10.2010

PËR NDËRTIMIN E KOMPLEKSIT TË RI PARLAMENTAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar në vendin ku ndodhet Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbunori” në Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet si aneksi 1 këtij vendimi.

II. Projekti i Kompleksit të ri Parlamentar realizohet me anë të konkursit ndërkombëtar, me ftesë për marrje pjesë studiove më të njohura ndërkombëtare, sipas detyrës së projektimit që i bashkëlidhet si aneksi 2 këtij vendimi.

III. Vlerësimi i projekteve të paraqitura kryhet nga një juri ndërkombëtare, e përbërë prej pesë arkitektësh të shquar, vendas dhe të huaj.

IV. Destinacioni i ndryshuar i sheshit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe procedura që do të ndiqet për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar përcaktohen me ligj të veçantë të Kuvendit.

V. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe akteve të tjera ligjore krijohet një komision shtetëror i përbërë nga:

- Kryetari i Kuvendit,
- Kryeministri,
- Ministri i Punëve Publike dhe Transporteve,
- Ministri i Financave,
- Kryetari i Bashkisë së Tiranës,
- Dy kryetarët e grupeve më të mëdha parlamentare në Kuvend,
- Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Komisioni Shtetëror, brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përcakton studiot e njohura ndërkombëtare, që u dërgohet ftesa për marrje pjesë, si dhe miraton Rregulloren e Organizimit të Konkursit Ndërkombëtar.

VI. Për realizimin e kësaj faze të ndërtimit të Kompleksit të ri Parlamentar, Kuvendi përdor një fond të ndarë sipas zërave në aneksin 3 të këtij vendimi.

VII. Pranë Kuvendit të Shqipërisë ngrihet Njësia Teknike e Ndhmës dhe Asistencës për realizimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Përbërja e Njesisë përcaktohet me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të sigurojë ndihmën dhe asistencën për realizimin e këtij projekti.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr.6733, datë 20.10.2010

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Haia M.Raghd Hajjazi
2. Hossam Nasr Hamed Ali
3. Jeta Agim Dashi (Shëndeti)
4. Kemal Recep Nuri Can
5. Lindita Azem Shehu (Gashi)
6. M.Raghd Jouma Hajjazi
7. Mais M.Raghd Hejjazi (Hajjazi)
8. Najla Samir Darwish Taleb
9. Pia Idrusa Domenico Marzo
10. Seyfullah Ahmet Koyun
11. Silvano Raffaele Tito Volpi

12. Tomor Selahudin Ajeti
13. Wasim M.Raghd Hajjazi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.563, datë 14.7.2010

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE TË HOLLËSISHME TË BASHKËPUNIMIT TË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR ME AGJENCINË E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA, SI DHE PAGESËN PËRKATËSE PËR SHËRBIMIN E PËRMBARIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14 pika 4 e 28 pika 4 të ligjit nr.10 192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe të ligjit nr.8730, datë 18.1.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit të përmbarimit gjyqësor”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE

1. Administratori, i caktuar në vendimin e gjykatës, i dorëzon kërkesën për ekzekutimin e vendimit përmbaruesit gjyqësor, ku ndodhet pasuria që sekuestrohet.
2. Vendimi i gjykatës për sekuestrimin e pasurive vihet në ekzekutim menjëherë, me paraqitjen e kërkesës, dhe duhet të ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve.
3. Përmbaruesi gjyqësor detyrohet të bashkërendojë me administratorin veprimet procedurale që lidhen me vendin, datën dhe orën e ekzekutimit të vendimit, brenda afateve të parashikuara në pikën 2 të këtij kreu.
4. Njoftimi i vendimit të gjykatës për personin zotërues të pasurisë, mbi të cilën është marrë masa e sekuestrimit, është i vlefshëm edhe për procedurën e ekzekutimit.

KREU II
MARRJA NË DORËZIM E PASURISË SË SEKUESTRUAR

1. Inventarizimi dhe dorëzimi i pasurive të sekuestruara, nga përmbaruesi gjyqësor tek administratori, dokumentohet me procesverbal, sipas nenit 524 të Kodit të Procedurës Civile, i cili nënshkruhet nga të pranishmit.
2. Procesverbali hartohet nga përmbaruesi gjyqësor në aq kopje sa janë të pranishmit në çastin e inventarizimit dhe dorëzimit të pasurive të sekuestruara.
3. Dorëzimi i pasurisë së sekuestruar tek administratori i pasurisë shoqërohet me dokumentacionin përkatës ligjor, nëse ka përfshirë dhe librat e llogarisë për shoqëritë tregtare, të cilat përmbaruesi gjyqësor ia kërkon personit zotërues të pasurisë.
4. Për qëllime administrimi, në mungesë të dokumentacionit të lartpërmendur, Agjencia mbledh të dhëna në rrugë zyrtare dhe ia vë në dispozicion ekspertit kontabël, të caktuar prej saj, i cili ia paraqet raportin përkatës kësaj Agjencie.

KREU III
EKZEKUTIMI I VENDIMIT TË GJYKATËS PËR KONFISKIM TË PASURIVE

1. Administratori i pasurisë ia dorëzon kërkesën për ekzekutimin e vendimit të konfiskimit përmbaruesit gjyqësor, të caktuar në vendimin e gjykatës.

2. Për ekzekutimin e vendimit për konfiskimin e pasurive zbatohen rregullat parashikuara në pikat 2 dhe 3 të kreut I të këtij vendimi.

3. Përmbaruesi gjyqësor urdhëron institucionet përgjegjëse për kalimin e pasurisë në pronësi të shtetit dhe në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, menjëherë pas marrjes së njoftimit të vendimit të konfiskimit.

4. Pasuritë e konfiskuara regjistrohen në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas dispozitave të Kodit Civil.

KREU IV
PAGESAT PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR

1. Pagesat e shërbimit përmbarimor për ekzekutimin e vendimit të sekuestrimit përcaktohen sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Agjencia përjashtohet nga pagesa paraprake e shërbimit për ekzekutimin e vendimit të konfiskimit.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Shërbimi Përmbarimor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela 1

	Tarifa për veprime që kryhen nga përmbaruesi gjyqësor	Masa e tarifës	
		Në lekë	Në %
1	Për vënien dhe ekzekutim të vendimeve të sekuestrimit të pasurive të pavleftësueshme	5000	
2	Për vënien në ekzekutim të vendimeve të sekuestrimit të objekteve të vleftësueshme		2%
3	Për lajmërimet dhe veprimet e tjera të përmbaruesit gjyqësor	500	
4	Për lëshime nga përmbaruesi gjyqësor të çdo lloj akti ose dokumenti të kërkuar nga të interesuarit	500	

UDHËZIM
Nr.1945, datë 4.10.2010

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.617, DATË 7.9.2006
“PËR PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË VLERËSIMIT DHE TË MONITORIMIT TË
PRORAMEVE TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË PAGESËS PËR PERSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUAR DHE TË SHËRBIMEVE SHOQËRORE”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore”,

UDHËZOJ:

I. Treguesit statistikorë për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar që plotësojnë bashkitë/komunat janë:

A. Statistikat për ndihmën ekonomike

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon:

1. Informacion mbi numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike me fondet nga buxheti qendror, sipas përbërjes së saj me anëtarë, numrin e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike dhe kanë në përbërjen e tyre edhe persona me aftësi të kufizuar, numrin e individëve që përfitojnë ndihmë ekonomike, numrin e familjeve me kryefamiljare gra, si edhe fondet për familje. Të dhënat plotësohen sipas mod.1, tab.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Informacion mbi numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e buxhetit të bashkisë/komunës sipas përbërjes së saj me anëtarë, numrin e familjeve dhe individëve në skemën e ndihmës ekonomike, numrin e kryefamiljareve gra dhe fondet për familje/individë. Të dhënat plotësohen sipas mod.1, tab.2, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Informacion mbi numrin e familjeve që hyjnë dhe dalin në skemën e ndihmës ekonomike, arsyet e kësaj lëvizjeje, sipas mod.1, tab.3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Informacion mbi numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike për fëmijët të lindur njëherësh, si: trinjakë, katërnjakë apo pesënjakë, për jetimët që kanë përfituar statusin e jetimit, dhe për kryefamiljarët që përfitojnë kompensim për rritjen e çmimit të energjisë elektrike sipas mod.1, tab.4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Informacionin mbi numrin e fëmijëve sipas grup-moshave e gjinisë, që janë në përbërje të familjeve/individëve përfitues të ndihmës ekonomike sipas mod.1, tab.5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

B. Statistikat për pagesën për personat me aftësi të kufizuar

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon informacionin mbi:

1. Numrin dhe gjininë e personave me aftësi të kufizuar: për të verbrit, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, personat me aftësi të kufizuara mendore, fizike, si dhe të kujdestarëve për secilin grup së bashku, numrin e invalidëve paraplegjikë e tetraplegjikë që përfitojnë një paketë të veçantë higjieno-sanitare me treguesit për fondet e përdorura për grupet e mësipërme sipas mod.1, tab. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Numrin e personave me aftësi të kufizuara mendore, fizike etj., sipas grup-moshave, gjinisë dhe sipas llojit të sëmundjes, sipas mod.1, tab.7, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Numrin e fëmijëve me aftësi të kufizuar në moshën 0-18 vjeç, gjithsej të ndarë sipas grup-moshave, sipas gjinisë dhe sistemit arsimor sipas mod.1, tab.8, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Numrin e invalidëve të punës që marrin pagesë për aftësinë e kufizuar sipas grup-moshave, sipas gjinisë, grupeve të invaliditetit dhe fondeve të përdorura sipas mod.1, tab.9, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

C. Periodiciteti i dërgimit të treguesve statistikorë të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar

1. Treguesit statistikorë sipas pikës I.A dhe B, për ndihmën ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar, formulohen dhe dërgohen një herë në 2 muaj (në datën 8 të muajit pasardhës) në zyrën rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe një kopje në sektorin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror në nivel qarku.

2. Zyrat rajonale, brenda datës 18 të muajit pasardhës, e përcjellin informacionin e përpunuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila në datën 30 të muajit pasardhës e përcjell në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

II. Treguesit statistikorë për shërbimet shoqërore që plotësojnë bashkitë/komunat

A. Statistikat për fëmijët

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon informacionin mbi:

1. Numrin e qendrave publike, rezidenciale e ditore që ofrojnë shërbime për fëmijët, numrin e përfituesve sipas llojit të shërbimeve, grup-moshave, sipas gjinisë, nivelit arsimor, sipas mod.2, tab.10, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Numrin e qendrave jopublike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për fëmijët, nga OJF-të vendase apo të huaja, private etj., numrin e përfituesve, llojit të shërbimeve, grup-moshave, gjinisë etj., si dhe fondet e përdorura, sipas mod.2, tab.11, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

B. Statistikat për të rinjtë

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon informacionin mbi:

1. Numrin e qendrave publike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për të rinjtë, sipas llojit të shërbimeve, grup-moshave, gjinisë, arsimit, si dhe fondet e harxhuara sipas mod.2, tab.12, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Numrin e qendrave jopublike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për të rinjtë, nga OJF-të vendase apo të huaja, private etj., numrin e përfituesve, llojit të shërbimeve, grup-moshave, gjinisë, si dhe fondet e përdorura sipas mod.2, tab.13, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

C. Statistikat për gratë

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon informacionin mbi:

1. Numrin e qendrave publike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për gratë, sipas llojit të shërbimeve, grup-moshave, arsimit, si dhe fondet e harxhuara, sipas mod.2, tab.14, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Numrin e qendrave jopublike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për gratë, nga OJF-të vendase apo të huaja, private, numrin e përfituesve, llojit të shërbimeve, grup-moshave, si dhe fondet e përdorura sipas mod.2, tab.15, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

D. Statistikat për të moshuarit

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon informacionin mbi:

1. Numrin e qendrave publike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për të moshuarit, llojin e shërbimeve, numrin e përfituesve sipas grup-moshave dhe gjinisë, si dhe fondet e harxhuara sipas mod.2, tab.16, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Numrin e qendrave jopublike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për të moshuarit nga OJF-të vendase apo të huaja, privat, llojin e shërbimeve, numrin e përfituesve sipas grup-moshave dhe gjinisë, si dhe fondet e harxhuara sipas mod.2, tab.17, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

E. Statistikat për personat me aftësi të kufizuar

Administratori shoqëror mbledh dhe përpunon informacionin mbi:

1. Numrin e qendrave publike rezidenciale apo ditore që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuar, llojin e shërbimeve, numrin e përfituesve sipas grup-moshave dhe gjinisë, përkujdesin familjar, si dhe fondet e harxhuara sipas mod.2, tab.18, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Numrin e qendrave jopublike rezidenciale apo ditore, që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuar nga OJF-të vendase apo të huaja, private, llojin e shërbimeve, numrin e përfituesve sipas grup-moshave dhe gjinisë, si dhe fondet e harxhuara sipas mod.2, tab.19, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

F. Periodiciteti i dërgimit të treguesve statistikorë

1. Treguesit statistikorë sipas pikës II.A, B, C, D, E për kategoritë që përfitojnë shërbime të përkujdesit për fëmijët, të rinjtë, gratë, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar dërgohen një herë në 4 muaj (në datën 8 të muajit pasardhës) në zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe një kopje në strukturat e shërbimeve sociale që operojnë në nivel qarku. Informacionin e përpunuar, zyrat rajonale të Shërbimit Social Shtetëror e përcjellin brenda datës 18 të muajit pasardhës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror analizon informacionin nga 12 zyrat rajonale dhe e dërgon në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta brenda datës 30 të muajit maj, shtator të vitit në vazhdim dhe në janar të vitit pasardhës.

Udhëzimi nr.2474, datë 6.12.2006 shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

TABELAT STATISTIKORE PËR NDIHMË EKONOMIKE, PAK DHE SHËRBIMET
SHOQËRORE BASHKËLIDHUR

PREFEKTURA _____
RRETHI _____
BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 – Tab.1

NUMRI I FAMILJEVE GJITHSEJ DHE FAMILJET NË NDIHMË EKONOMIKE

Nr.	Emërtimi	Njësia matjes	Gjithsej	2-mujori	
				Ndihmë e pjesshme	Ndihmë e plotë
A	Numri i familjeve gjithsej sipas regjistrit	Numër			
B	Numri i familjeve në ndihmë ekonomike gjithsej:	Numër			
1	me 1 anëtar me 2 anëtarë me 3 anëtarë me 4 anëtarë me 5 anëtarë me 6 anëtarë me mbi 6 anëtarë.				
2.	Numri familjeve në ndihmë ekonomike që kanë në përbërje PAK	Numër			
2.1	Numri i familjeve në ndihmë ekonomike që kanë në përbërje romë				
2.2	Numri i familjeve në ndihmë ekonomike me kryefamiljare gra				
3	Numri i individëve në ndihmë ekonomike Nga këta: - jetimë - viktima të trafikimit				
4	Fondi i ndihmës ekonomike për familjet: me 1 anëtar me 2 anëtarë me 3 anëtarë me 4 anëtarë me 5 anëtarë me 6 anëtarë me mbi 6 anëtarë	000/lekë			

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
(_____)

KRYETARI
(_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 – Tab.2

NUMRI I FAMILJEVE QË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE NGA FONDET E BASHKIVE/KOMUNAVE

Emërtimi	Njësia e matjes	Gjithsej	K/Familjare	Ndarë në:			
				grup-mosha			Nga këta sa me AK
				Femra	0-6 vjeç	6-15 vjeç	
1 Numri i familjeve gjithsej: me 1 anëtar me 2 anëtarë me 3 anëtarë me 4 anëtarë me 5 anëtarë me 6 anëtarë me mbi 6 anëtarë Nga këta – me aftësi të kufizuar Nga këta – romë	Numër						
2 Fondi për familjet gjithsej me 1 anëtar me 2 anëtarë me 3 anëtarë me 4 anëtarë me 5 anëtarë me 6 anëtarë me mbi 6 anëtarë	000/lekë						

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 KOMUNA/BASHKIA _____

Mod.1 – Tab.3

NUMRI I FAMILJEVE TË HYRA DHE TË DALA NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE PËR MUAJIN _____

EMËRTIMI	Numri i familjeve të muajit	Numri i familjeve të muajit	Gjithsej	Arsyet që familjet kanë hyrë në skemë					Gjithsej	Arsyet që familjet kanë dalë nga skema							gjinia k/familjarit	
				nga pagesë papunësie	familje të ardhura nga zona të tjera	krijimi i familjeve të reja	Invalidët e punës	Të ndryshme		punësim vetëpunësim	emigracion	kontrolli	Të zhvendosur	Të ndryshme	Kohëzgjatja në skemë			
															deri 2	2-5 vjet		mbi 5
Familje gjithsej			1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
me 1 anëtar																		
me 2 anëtarë																		
me 3 anëtarë																		
me 4 anëtarë																		
me 5 anëtarë																		
me 6 anëtarë																		
mbi 6 anëtarë																		
Nga këta romë																		

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI

KRYETARI KOMUNËS

Firma / vula

PREFEKTURA _____
RRETHI _____
BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 – Tab.4

FAMILJE NË NDIHMË EKONOMIKE ME SHUMË FËMIJË, ME FËMIJË JETIMË DHE K/F.
PËRFITUES TË KOMPENSIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Nr.	Emërtimi	Gjithsej	Individë
1	Numri i familjeve në ndihmë ekonomike me fëmijë 0–15 vjeç, Nga këto: - Familje me fëmijë trinjakë - Familje me fëmijë katërnjakë - Familje me fëmijë pesënjakë Nga këto - romë		
2	- Jetimë të moshës 18–25 vjeç - Jetimë të papunë mbi 25 vjeç Nga këta - romë		
3	K./familjare përfitues të energjisë elektrike Nga këta - romë		

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
(_____)

KRYETARI
(_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 – Tab.5

NUMRI I FAMILJEVE DHE INDIVIDËVE NË NDIHMË EKONOMIKE ME FËMIJË 0-15 VJEÇ

Nr.	Emërtimi	Gjithsej familje	Gjithsej individë	K./familjare Femra	Sa fëmijë frekuentojnë shkollën			
					Klasa 1-5		Klasa 6-9	
					F	M	F	M
1	Nr. familjeve në ndihmë ekonomike me fëmijë 0-18 vjeç, ndarë në: A - familje me fëmijë 0-6 vjeç nga këta – romë B - familje me fëmijë 6-15 vjeç nga këta – romë C - familje me fëmijë mbi 15 vjeç nga këta – romë							

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 – Tab.6

NUMRI DHE FONDI I PERSONAVE ME AK I NDARË SIPAS GRUPEVE TË PAK DHE SIPAS PAGESËS PËR DYMUJORIN _____

Nr.	EMËRTIMI	2-MUJORI _____						PREJ FILLIMIT TË VITIT						K./FAMIL.
		Me PAK (D+E+F+G)	Me 100%	Me 150%	Me 200%	Me 300%	Me përf. Kujdest	Gjithsej (D+E+F+G)	Me 100%	Me 150%	Me 200%	Me 300%	Me përf. Kujdest	ME AK
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	ENER. EL.
1	Numri i personave me AK gjithsej													
	Nga këta:													
	Rom													
1.a	Të verbër													
	- grupi I													
	- grupi II													
	nga këta romë													
1.b	Paraplegjikë dhe tetraplegjikë													
	- grupi I													
	Nga këta: marrin paketën higjieno-sanitare													
	- grupi II													
	nga këta romë													
1.c	PAK. mendor, fizik, shqisor													
	- grupi I													
	- grupi II													
	nga këta romë													
2	Fondi i PAK gjithsej (000/lekë)													
	Nga ky për:													
2.a	Të verbër													
2.b	Paraplegjikë dhe tetraplegjikë													
2.c	PAK mendor, fizik, shqisor													

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 – Tab.7

NUMRI I PAK FIZIK, MENDOR ETJ. SIPAS GRUP-MOSHAVE DHE GRUP-SËMUNDJEVE

NR.	EMËRTIMI	GJITHSEJ	Nga gjithsej sa me kujdestari	Nga gjithsej, sa në familje me NE	Përfitues të rinj	Ndërprerje përfitimi	Vdekur	Sëmundje	
								Të lindur	Të fituar
1	GJITHSEJ NR. Nga këta romë								
2	NGA GJITHSEJ, SA FEMRA Nga këta romë								
3	NGA GJITHSEJ, NDARË SIPAS GRUP-MOSHAVE								
	0-3 VJEÇ Nga këta romë								
	4-18 VJEÇ Nga këta romë								
	19-21 VJEÇ Nga këta romë								
	22-60 VJEÇ Nga këta romë								
	MBI 60 VJEÇ Nga këta romë								
4	NGA GJITHSEJ, NDARË SIPAS GRUP-SËMUNDJEVE								
	- me probleme në shëndetin mendor								
	a)								
	b) nga këta fëmijë 0-18 vjeç								
	c) nga këta romë								
	- me aftësi të kufizuar mendore								
	a)								
	b) nga këta fëmijë 0-18 vjeç								
	c) nga këta romë								
	- me aftësi të kufizuar fizike								
	a)								
	b) nga këta fëmijë 0-18 vjeç								
	c) nga këta romë								
	- me aftësi të kufizuar të përzier								
	a) nga këta romë								
	- me autizëm								
	- me HIV - AIDS								
	a) nga këta fëmijë 0-18 vjeç								
	b) nga këta romë								

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
RRETHI _____
BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 - Tab.8

NUMRI I FËMIJËVE (0-18 VJEÇ) TË VERBËR, PARA-TETRAPLEGJIKË DHE
ME AFTËSI TË KUFIZUAR FIZIKE MENDORE DHE SHQISORE

NR.	EMËRTIMI	GJITHSEJ	FEMRA	SISTEMI ARSIMOR QË NDJEKIN		
				parashkollor	9-vjeçar	i mesëm
1	Fëmijë gjithsej					
	nga këta - romë					
2	Nga gjithsej, ndarë sipas grup-moshave					
	0-6 vjeç					
	nga këta - romë					
	6-15 vjeç					
	nga këta - romë					
	15-18 vjeç					
	nga këta - romë					

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
(_____)

KRYETARI
(_____)

PREFEKTURA _____
RRETHI _____
BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.1 - Tab.9

NUMRI I INVALIDËVE TË PUNËS SIPAS GRUP-MOSHAVE, LLOJIT TË INVALIDITETIT DHE
FONDI I SHPËRNDARË

NR.	EMËRTIMI	GJITHSEJ	FEMRA	MESHKUJ
1	Gjithsej (numër fizik)			
2	Nga gjithsej ndarë sipas grup-moshave			
	Deri në 30 vjeç			
	31 - 40			
	41 - 50			
	51 - 60			
	Mbi 60 vjeç			
3	Nga gjithsej ndarë sipas grupeve të invaliditetit			
	A. Invaliditet i plotë			
	B. Invaliditet i pjesshëm			
	C. Invaliditet me pension pleqërie			
4	Fondi i invalidit të punës (000/L)			
	A. Invaliditet i plotë			
	B. Invaliditet i pjesshëm			
	C. Invaliditet me pension pleqërie			

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo dy muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
(_____)

KRYETARI
(_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.10

NUMRI I QENDRAVE PUBLIKE PËR FËMIJËT NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIMET E PËRKUJDESIT

Nr.	EMËRTIMI	Gjithsej	Lloji i qendrave		Nga gjithsej	Sipas grup-moshës			Arsimi		Përkujdesi familjar	
			Rezidenciale	Ditore	Femra	0-5 vjeç	6-15 vjeç	16-18 vjeç	9-vjeçar	i mesëm	Me familje	Pa familje
			a	1	2	3	4	5	6	7	8	9
I	Numri i qendrave gjithsej 1-Lloji i shërbimit: a) b) c)											
II	Numri i klientëve përfitues, nga këto: - me aftësi të kufizuara - romë - të huaj											
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) - nga këta romë - të huaj 1-Lloji i shërbimit a) b) c)											
IV	Fondi i shpenzimeve (000/lekë) (sipas llojit dhe statusit të klientit)											

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.11

NUMRI I QENDRAVE JOPUBLIKE PËR FËMIJËT NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIMET E PËRKUJDESIT

Nr.	EMËRTIMI	Gjithsej	Lloji i qendrave		Nga gjithsej	Sipas grup-moshës			Arsimi		Përkujdesi familjar	
			rezidenciale	ditore	Femra	0-5 vjeç	6-15 vjeç	16-18 vjeç	9-vjeçar	i mesëm	Me familje	Pa familje
			a	1	2	3	4	5	6	7	8	9
I	Numri i qendrave gjithsej 1-Lloji i shërbimit a) b) c)											
II	Numri i klientëve përfitues, nga këta: - Me aftësi të kufizuara - romë - të huaj											
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) - nga këta romë - të huaj											
IV	Fondi i shpenzimeve (000/lekë) (sipas llojit dhe statusit të klientit)											

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.12

NUMRI I QENDRAVE PUBLIKE PËR TË RINJ NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI	Gjithsej	Lloji i qendrave		Femra	Grup-mosha		Arsimi		Me familje	Pa familje
			rezidenciale	ditore		18-22 vjeç	mbi 22 vjeç	9-vjeçar	i mesëm		
			1	2		3	4	5	6		
I	Numri i qendrave gjithsej										
II	Numri i klientëve përfitues gjithsej - nga këta me aftësi të kufizuara - nga këta romë - të huaj										
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) gjithsej - nga këta me aftësi të kufizuara - nga këta romë - të huaj										
IV	Fondi i shpenzimeve (000/lekë) (sipas llojit dhe statusit të klientit)										

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.13

NUMRI I QENDRAVE JOPUBLIKE PËR TË RINJ NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI a	Gjithsej 1	Lloji i qendrave		Femra 4	Grup-mosha		Arsimi		Me familje 9	Pa familje 10
			rezidenciale 2	ditore 3		18-22 vjeç 5	mbi 22 vjeç 6	9-vjeçar 7	i mesëm 8		
I	Numri i qendrave gjithsej 1-Lloji i shërbimit a) b) c)										
II	Numri i klientëve përfitues gjithsej - nga këta me aftësi të kufizuara - nga këta romë - të huaj										
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) - nga këta me aftësi të kufizuara - nga këta romë - të huaj										
IV	Fondi i shpenzimeve (000/lekë) (sipas llojit dhe statusit të klientit)										

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____

RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.14

NUMRI I QENDRAVE PUBLIKE PËR GRA NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESEVE DHE KËRKUESEVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI	Gjithsej	Lloji i qendrave		Grup-mosha			Arsimi		Me familje	Pa familje
			rezidenciale	ditore	18-25 vjeç	25-35 vjeç	mbi 35 vjeç	9-vjeçar	i mesëm		
	a	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I	Numri i qendrave gjithsej sipas llojit të shërbimit a) b) c)										
II	Numri i klientëve përfitues 1 - Lloji i shërbimit a) b) c) 2 - Nga këta me aftësi të kufizuara 3- Nga këta romë 4- Nga këta të huaj										
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) - Nga këta me aftësi të kufizuara - Nga këta romë - Nga këta të huaj										
IV	Fondi i shpenzimeve (000/lekë) (sipas llojit dhe statusit të klientit)										

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.15

NUMRI I QENDRAVE JOPUBLIKE PËR GRA NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESEVE DHE KËRKUESEVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI a	Gjithsej 1	Grup-mosha			Arsimi		Me familje 9	Pa familje 10	Lloji i qendrës	
			18-25 vjeç 4	25-35 vjeç 5	mbi 35 vjeç 6	9-vjeçar 7	i mesëm 8			rezidenciale	ditore
I	Numri i qendrave gjithsej sipas llojit të shërbimit a) b) c)										
II	Numri i klientëve përfitues 1 – Lloji i shërbimit a) b) c) 2 – Nga këta me aftësi të kufizuara 3 – Nga këta romë 4 – Nga këta të huaj										
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) - nga këta me aftësi të kufizuara - nga këta romë - nga këta të huaj										
IV	Fondi i shpenzimeve (000/lekë) (sipas llojit dhe statusit të klientit)										

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.16

NUMRI I QENDRAVE PUBLIKE PËR TË MOSHUAR NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI	Gjiths ej	Lloji i qendrave		Femra	Grup-mosha			Me familje	Pa familje	Me të ardhura	Pa të ardhura
			rezidenciale	dito re		nën 65 vjeç	65-75 vjeç	mbi 75 vjeç				
	a	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
I	Numri i qendrave gjithsej											
II	Numri i klientëve përfitues gjithsej - Nga këta: - me aftësi të kufizuar - romë - të huaj											
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) Nga këta: - me aftësi të kufizuar - romë - të huaj											
IV	Fondi i shpenzimeve (sipas llojit dhe statusit të klientit)											

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.17

NUMRI I QENDRAVE JOPUBLIKE PËR TË MOSHUAR NË NEVOJË, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI	Gjithsej	Femra	Grup-mosha			Me familje	Pa familje	Me të ardhura	Pa të ardhura	Lloji i qendrave	
				nën 65 vjeç	65-75 vjeç	mbi 75 vjeç					rezidenciale	ditore
a		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
I	Numri i qendrave gjithsej 1-Lloji i shërbimit a) b) c)											
II	Numri i klientëve përfitues gjithsej nga këta: - me aftësi të kufizuara - romë - të huaj											
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) nga këta: - Me aftësi të kufizuara - romë - të huaj											
IV	Fondi i shpenzimeve (sipas llojit dhe statusit të klientit)											

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.18

NUMRI I QENDRAVE PUBLIKE PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI	Gjithsej	Lloji i qendrave		Femra	Grup-mosha				Përkujdesi familjar	
			rezidenciale	ditore		Deri 18 vjeç		Mbi 18 vjeç		Me familje	Pa familje
						rezidenciale	ditore	rezidenciale	ditore		
	a	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I	Numri i qendrave gjithsej – Lloji i shërbimit a) b) c)										
II	Numri i klientëve përfitues – Kategoritë përfituese a) b) c) Romë d) Të huaj										
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) Nga këto: Romë Të huaj										
IV	Fondi i shpenzimeve (sipas llojit dhe statusit të klientit)										

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

PREFEKTURA _____
 RRETHI _____
 BASHKIA/KOMUNA _____

Mod.2 – Tab.19

NUMRI I QENDRAVE JOPUBLIKE PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR, NUMRI I PËRFITUESVE DHE KËRKUESVE PËR SHËRBIME SOCIALE

Nr.	EMËRTIMI	Gjithsej	Lloji i qendrave		Femra	Grup-mosha				Përkujdesi familjar	
			rezidenciale	ditore		Deri në 18 vjeç		Mbi 18 vjeç		Me familje	Pa familje
						rezidenciale	ditore	rezidenciale	ditore		
	a	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
I	Numri i qendrave gjithsej – Lloji i shërbimit a) b) c)										
II	Numri i klientëve përfitues – Kategoritë përfituese a) b) c) Romë d) Të huaj										
III	Numri i klientëve në nevojë (kërkesa) Nga këta romë Nga këta të huaj										
IV	Fondi i shpenzimeve (sipas llojit dhe statusit të klientit)										

Shënim. Evidenca është e detyrueshme çdo 4 muaj brenda datës 10 të muajit pasardhës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.617, datë 7.9.2006.

ADMINISTRATORI
 (_____)

KRYETARI
 (_____)

UDHËZIM
Nr.36, datë 7.10.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.40, DATË 24.12.2008 “PËR CAKTIMIN E
TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992 “Për çmimet dhe tarifat”, të ndryshuar, dhe të nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Telekomunikacionit

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.40, datë 24.12.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë” bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pika 1 zëvendësohet me pikën 1, më përmbajtje si më poshtë vijon:

“1. Tarifa e shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë është në shumën 10 euro dhe paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës, përveç rastit kur udhëtari është tranzit dhe nuk e kalon kufirin, por qëndron në ambientet e aeroportit deri në vazhdimin e udhëtimit të tij.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT**
Sokol Olldashi

VENDIM
Nr.35, datë 27.10.2010

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,		
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Ploçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Bashkim Dedja	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 14.9.2010, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. Akti, që i përket:

KËRKUESE: Luiza Melengu, përfaqësuar nga avokat Denis Selimi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Zyra e përmbarrimit, TIRANË, në mungesë.

Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, përfaqësuar nga Erjon Kafazi me autorizim.

OBJEKTI: 1. Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.917, datë 20.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

2. Detyrimi i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar të ekzekutojë këtë vendim, të dëmshpërblejë dëmin financiar për vonesën e pagesës dhe dëmin jofinanciar në shumën 3 000 euro si dhe të paguajë kostot dhe shpenzimet në shumën 3 000 euro.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 132/1, 134/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet 6 e 41 të Konventës europiane për të drejtat e njeriut, nenet 27 e 28 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin përfaqësuesin e kërkuases Luiza Melengu që kërkoi pranimin e kërkesës dhe përfaqësuesin e subjektit të interesuar: Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr.917, datë 20.6.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë së paditëses Luiza Melengu, detyrimin e Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar (INUK) të paguajë në favor të kërkuases 3 paga mujore në masën 3 x 51645 lekë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës; 2 paga mujore në masën 2 x 51645 lekë si dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, sipas nenit 144 të Kodit të Punës; shpërblimin për vjetërsi pune në masën 6.5 muaj, duke iu referuar pagës së paditëses; rrëzimin e padisë për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj e në prova.

Më datë 15.7.2008, ky vendim gjyqësor ka marrë formë të prerë.

Me vendimin nr.154, datë 10.09.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur lëshimin e urdhrat ekzekutiv për vendimin civil nr.917, datë 20.6.2008 të kësaj Gjykate.

2. Zyra e përmbarimit Berat ka vërejtur se nuk ishte kompetente për ekzekutimin e titullit ekzekutiv dhe ia ka dërguar aktet Zyrës së Përmbarimit Tiranë. Kjo e fundit nuk ka mundur të ekzekutojë vendimin, duke u shprehur se INUK ka mungesë fondesh.

Zyra e përmbarimit ka informuar Gjykatën Kushtetuese me shkresën nr. prot. 7492, datë 11.5.2010 se çështja përmbarimore është transferuar nga Zyra e Përmbarimit Berat në datën 2.10.2009 dhe në zbatim të titullit ekzekutiv janë kryer këto veprime:

- Lajmërim për ekzekutim vullnetar me nr. 14149 prot. i datës 13.11.2008, bazuar në nenin 517 e në vijim të Kodit të Procedurës Civile.

- Kërkesë për ekzekutim të titujve ekzekutivë me nr.7772 prot. e datës 3.5.2009.

- Kërkesë për ekzekutim të titujve ekzekutivë me nr.14790 prot. e datës 1.10.2009.

- Kërkesë për ekzekutim të titujve ekzekutivë me nr.6589 prot. të datës 27.4.2010.

3. Zyra e përmbarimit informon Gjykatën Kushtetuese se Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar ka kthyer në shumicën e rasteve përgjigje, duke u justifikuar me mungesën e fondeve, se INUK-u kishte në gjendje vetëm 5 milionë lekë dhe se me këtë shumë do të ekzekutoheshin në masën 66 % vetëm vendime për 17 kreditorë, duke i marrë sipas radhës së daljes së vendimeve të gjykatave dhe se në fillim të vitit të ardhshëm do të procedohej me diferencat dhe me pjesën tjetër.

4. Kërkuësja pretendon përpara Gjykatës Kushtetuese se:

- i është cenuar e drejta e saj, e mbrojtur nga neni 6/1 i Konventës europiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ) për një gjykim të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm. E drejta që i është njohur asaj me vendimin nr.917, datë 20.6.2008 mbetet iluzive, pasi vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk është veprues, në dëm të kërkuases. Vonesat në ekzekutimin e vendimit gjyqësor mund të justifikohen në rrethana të caktuara, por nuk mund të jenë të tilla që të cenojnë thelbin e së drejtës që garanton neni 6/1 i Konventës;

- janë shkelur nenet 534 dhe 535 të Kodit të Procedurës Civile dhe se detyrimi ndaj kërkuases duhej të ishte shlyer në mënyrë proporcionale ndërmjet të gjithë kreditorëve.

5. Subjekti i interesuar, INUK-u, parashtron se:

- INUK-u është institucion juridik publik në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit dhe mbulohet 100 për qind nga Buxheti i Shtetit. Ky institucion ka kërkuar nga organet eprore financiare përkatëse çeljen e fondeve për shlyerjen e detyrimeve të lindura nga urdhrat e ekzekutimit;

Për vitin 2009 INUK-ut iu miratua shuma 5 000 000 lekë për detyrimet dhe kompensimet ligjore, nga të cilat u shlyen 18 kreditorë;

Për vitin 2010 INUK-u ka kërkuar çeljen e një fondi me vlerë 10 000 000 lekë për shlyerjen e detyrimeve të mbetura;

- INUK nuk e ka vënë në asnjë çast në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe ka marrë masa për përmbushjen e tyre. Por INUK-u është i kufizuar në burimet financiare që ka në dispozicion. Ndaj dhe vonesa në ekzekutim është e justifikuar në këto rrethana të veçanta që kanë të bëjnë me pamjaftueshmërinë dhe mosçeljen në kohë të shpejtë të fondeve nga organet përkatëse;

- kërkesa e kërkueses, që Gjykata Kushtetuese të detyrojë INUK-un, që të ekzekutojë vendimin gjyqësor, nuk duhet të merret në shqyrtim nga kjo gjykatë, pasi nuk përfshihet në kompetencën e saj sipas nenit 132 pika 1 të Kushtetutës.

- kërkesja nuk legjitimohet në pjesën e kërkesës për dëmshpërblimin financiar që INUK-u duhet të kryejë ndaj kërkueses, për shkak të mosezaurimit të mjeteve të tjera ligjore e kushtetuese.

II

A. Lidhur me pretendimin se kërkueses i është cenuar e drejta për një proces të rregullt gjyqësor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

6. Fillimisht Gjykata Kushtetuese vlerëson çështjen e legjitimitetit të kërkueses lidhur me këtë pretendim. Gjykata çmon se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, pasi sipas nenit 134 shkronja "g" të Kushtetutës, individët mund të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për çështje që lidhen me interesat e tyre. Kërkesja legjitimohet *ratione temporis*, pasi objekt i kërkesës është mosekzekutimi i një vendimi të formës së prerë, si edhe *ratione materiae*, pasi kërkesa e paraqitur hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese në pjesën e shprehur në objektin e kërkesës: "*Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.917, datë 20.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat*".

7. Në shumë raste, Gjykata Kushtetuese është shprehur se nenet 42, 142/3 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ-së (*shih vendimet nr.27, datë 20.6.2007; nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*vendimi nr.6, datë 31.3.2006; nr.6, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

8. Gjykata ka vlerësuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata është shprehur edhe më parë se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (*shih vendimin nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.43, datë 19.12.2007*).

9. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve brenda afatit të arsyeshëm, edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) shprehet se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, si pjesë e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, është element i procesit të rregullt gjyqësor sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, të gjitha shtetet detyrohen të organizojnë sistemin juridik në mënyrë të tillë që gjykatat të mundësojnë shqyrtimin e të gjitha çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, sepse sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa që çojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në to (*shih çështjen Bageta kundër Italisë, vendim i datës 25.06.1998 i GJEDNJ-së*). GJEDNJ ka sqaruar se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe kur ai ekzekutohet (*shih çështjen Giralanci kundër Italisë, vendim i datës 19.02.1999 i GJEDNJ-së*), dhe se faza e ekzekutimit duhet të llogaritet, pra të konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih çështjen Vakaturu kundër Italisë, vendim i datës 25.05.1991 i GJEDNJ-së*). Gjykata ka konfirmuar se kohëzgjatja

e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkuesit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, vëllimin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*vendimi "Cravcenko kundër Moldavisë", datë 15.4.2008 i GJEDNJ-së*).

10. Gjykata Kushtetuese, me qëllim analizimin e sjelljes së palëve në dritën e standardeve kushtetuese në çështjen objekt shqyrtimi, merr në konsideratë edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC) lidhur me zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto dispozita sqarojnë procedurat ligjore, të cilat duhen plotësuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

11. Neni 451/a (paragrafi i parë) i KPC-së parashikon se vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Neni 510 i KPC-së parashikon se ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv dhe se janë tituj ekzekutivë, ndër të tjera, vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë. Neni 511 parashikon se titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim me kërkesën e kreditorit dhe, për këtë qëllim, lëshohet urdhri i ekzekutimit nga gjykata sipas parashikimeve të nenit 511 të KPC-së. Urdhri i ekzekutimit vihet në ekzekutim nga përmbartuesi gjyqësor ndër të tjera edhe me kërkesën e kreditorit (neni 515). Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor mund të bëhet fillimisht me ekzekutim vullnetar. Kështu, neni 517 i KPC-së parashikon kriteret për lajmërimin për ekzekutim vullnetar sipas të cilit përmbartuesi gjyqësor, kur fillon ekzekutimin, i dërgon debitorit një lajmërim për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban urdhri i ekzekutimit, duke i caktuar për këtë një afat prej 5 ditësh, kur objekti është pagë ose detyrim për ushqim, dhe prej 10 ditësh në të gjitha rastet e tjera. Neni 518 i KPC-së parashikon se lajmërimi duhet ndër të tjera të përmbajë paralajmërimin që i bëhet debitorit se do të fillojë ekzekutimi i detyrueshëm në qoftë se urdhri i ekzekutimit nuk ekzekutohet vullnetarisht prej tij brenda afatit të caktuar në lajmërim. Neni 519 i KPC-së parashikon kriteret për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, i cili nuk mund të fillojë para se të kenë kaluar afatet e parashikuara në nenin 517. Neni 537 parashikon se kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, përmbartuesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes, duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim dhe nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre.

12. Në çështjen në shqyrtim, është e nevojshme të vlerësohet nëse zyra e përmbartimit Tiranë ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrin të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe, në këtë mënyrë, vlerësohet nëse veprimet ose mosveprimet janë në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

13. Zyra e përmbartimit ka informuar Gjykatën Kushtetuese se hapat proceduralë të ndërmarrë prej saj janë lajmërimi për ekzekutim vullnetar dhe tri kërkesa për ekzekutim të titujve ekzekutivë drejtuar INUK-ut, më e fundit e datës 27.4.2010. Zyra e përmbartimit më tej informon se INUK-u ka kthyer në shumicën e rasteve përgjigje se nuk ka mundësi të ekzekutojë vendimin gjyqësor duke u justifikuar me mungesën e fondeve.

14. Gjykata Kushtetuese vëren se nga rrethanat e çështjes rezulton që urdhri ekzekutiv i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat mban datën 10.9.2008. Pra, kanë kaluar rreth dy vjet nga data që ka dalë ky urdhër dhe ai ende nuk është zbatuar. Si është shprehur edhe më parë Gjykata Kushtetuese, mungesa e fondeve nuk përbën argument për të justifikuar mosekzekutimin e vendimit gjyqësor. Shpjegimet e parashtruara para Gjykatës nga zyra e përmbartimit dhe INUK-u lidhur me ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të kërkueses nuk e bindën Gjykatën se këto organe i kanë marrë të gjitha masat për të filluar, qoftë edhe pjesërisht, shlyerjen e detyrimit ndaj kërkueses, sipas parashikimeve të nenit 537 të KPC-së, ku thuhet se, kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, përmbartuesi gjyqësor përgatit projektin e ndarjes, duke veçuar më parë shumat që nevojiten për kreditë që paguhen me preferim dhe, nga pjesa tjetër që mbetet, paguan kreditë e tjera në përpjesëtim me shumat e tyre. Ndaj Gjykata çmon se në rastin në shqyrtim nuk ka arsye të bazuara që të justifikojnë mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

B. Lidhur me pretendimin për dëmshpërblim

15. Gjykata çmon se sa i përket kërkesës së kërkueses, që Gjykata Kushtetuese të detyrojë INUK-un të ekzekutojë vendimin, të dëmshpërblejë dëmin financiar për vonesën e pagesës dhe dëmin jo

financiar në shumën prej 3 000 euro dhe 3 000 euro për kostot dhe shpenzimet, kërkesja nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për shkak se nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese e ligjore, parakusht ky i sanksionuar në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetutës. Gjykata arrin në këtë përfundim, pasi mbrojtja juridike e kërimit të këtij dëmi në bazë të nenit 42 të Kushtetutës, të KC dhe të KPC realizohet me anë të ngritjes dhe gjyqimit të padisë me një objekt të tillë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të pushtetit gjyqësor, të parashikuara nga neni 135 i Kushtetutës. Pas shterimit të këtyre mjeteve juridike individë, për mbrojtjen e kësaj të drejte, mund t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, por kurdoherë që shkelja e të drejtës së tij kushtetuese të jetë e lidhur detyrimisht me një proces të parregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 49/2 e 51 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.917, datë 20.6.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Petrit Ploçi, Xhezair Zaganjori, Admir Thanza, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Bashkim Dedja.

VENDIM

Nr.69, datë 30.9.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR GARANCITË FINANCIARE TË PJESËMARRËSVE PËR REGJISTRIMIN NË TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të pikës III.2.4, kapitulli III të "Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike", të miratuara nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr.68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.9.2010, pasi shqyrtoi draftin e rregullave për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike dhe relacionin përkatës të drejtorive teknike,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat për garancitë financiare të pjesëmarrësve për regjistrimin në tregun e energjisë elektrike (rregullat bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta**

VENDIM
Nr.70, datë 6.10.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.45, DATË 30.7.2007 “PËR MIRATIMIN E
MEMORANDUMIT TË MIRËKËPTIMIT MBI BASHKËPUNIMIN NDËRMJET ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHQIPËRISË DHE ENTIT
RREGULLATOR TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË TURQISË**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “gj” dhe nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.10.2010, pasi shqyrtoi ndryshimet e propozuara për Memorandumin e mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet enteve rregullatore të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Turqisë,

VENDOSI:

1. Të bëjë ndryshimet e Memorandumit të mirëkuptimit mbi bashkëpunimin ndërmjet Entit Rregullator të Energjisë Elektrike të Shqipërisë dhe Entit Rregullator të Tregut të Energjisë Elektrike të Turqisë. (Memorandumi me ndryshimet përkatëse bashkëlidhur këtij vendimi.)
2. Ngarkohet kryetari i ERE-s të nënshkruajë për ERE-n këtë Memorandum Mirëkuptimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë për ndjekjen e zbatimit të këtij Memorandumi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.71, datë 11.10.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË KESH SHA PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË VITIT 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të Planit të Investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Aplikimi i KESH sh.a. për planin e investimeve për vitin 2011 përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit” në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të KESH sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.72, datë 11.10.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË OST SHA PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË VITIT 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 9 të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit” në sektorin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

Konstatoi se:

Aplikimi i OST sh.a. për planin e investimeve për vitin 2011 përmbush përgjithësisht detyrimin e paraqitjes së aplikimit në zbatim të rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit” në sektorin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.73, datë 11.10.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1 germa “a” dhe 13 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesëshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Peshk ” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Peshk”, me fuqi 3.43 MW.

2. Afati i kohëzgjatjes së licencës do të jetë 30 vjet.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.74, datë 11.10.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “YLLIAD” SHPK NË
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pikat 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8 dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pikat 1 germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Ylliad” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Ylliad” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.75, datë 11.10.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “ENERGY PLUS”
SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pikat 1 germa “d”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8 dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formatimi i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licencë të shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.76, datë 11.10.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“ENERGY PLUS” SHPK**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13, pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1 germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energy Plus” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Pobreg”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

KËRKESË

Nr.4140/2, datë 14.10.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Kalimash-Morinë”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listë emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruar me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit: tokë arë.

Për të gjitha pasuritë për të cilat është bërë shënimi “Rikonfirmim”, do të kërkohet rikonfirmim pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 1 584 424 (një milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e katër) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldash

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NË SEGMENTIN RRUGOR “KALIMASH-MORINË”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Tokë arë			Shënime
						SIP. m ²	Çmimi lekë/ m ²	Vlera lekë	
1	Fidaim	Ali	Dida	1176	110/34	897	224	200928	Rikonfirmim pranë ZRRP-së
2	Halil	Ali	Dida	1176	110/11	1268	224	284032	Rikonfirmim pranë ZRRP-së
3	Haki	Xheladin	Matmuja	1176	247/8	3368	224	754432	Rikonfirmim pranë ZRRP-së
4	Maksut	Vehap	Matmuja	2912	97/43	688	190	130720	Rikonfirmim pranë ZRRP-së
5	Hamit	Rexhep	Taci	1726	40/9	1204	178	214312	Rikonfirmim pranë ZRRP-së
		Totali				7425		1584424	

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.1641, datë 15.7.2010, shpall të zhdukur shtetasin Lefter Luman Beqari, i datëlindjes 30.3.1968, lindur në Përmet dhe banues në Elbasan.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 4.11.2010

Doli nga shtypi më 6.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë